




Teknikat e avokimit për Dhomat e Tregtisë dhe Shoqatat e Biznesit



Ndërto argumentin!

Formëso mesazhin!

Krijo ndikim!

Një program praktik mbi teknikat e avokimit dhe komunikimit strategjik për Dhomat e Tregtisë dhe Shoqatat e Biznesit. Nga ndërtimi i argumentit të besueshëm te mesazhi publik që ndikon vendimmarrjen.

13-14

SHKURT 2026

Mövenpick Hotel Lalëz

Mbështetur nga



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

State Secretariat for Economic Affairs SECO

Rreth workshop-it

Ky trajnim dy-ditor synon të forcojë aftësitë e Dhomave të Tregtisë dhe Shoqatave të Biznesit në ndërtimin dhe komunikimin e pozicioneve të besueshme të avokimit, të bazuara në interesin publik dhe evidencë. Programi kombinon teknikat e avokimit të politikave me komunikimin strategjik për të kthyer propozimet në ndikim real publik dhe institucional.

Dita e parë fokusohet në identifikimin e çështjeve prioritare, ndërtimin e argumenteve të qarta dhe hartimin e propozimeve të politikave të realizueshme. Dita e dytë i kushtohet komunikimit të këtyre propozimeve: formulimit të mesazheve publike, përshtatjes sipas audiencave dhe bashkëpunimit me median për rritjen e dukshmërisë dhe ndikimit në vendimmarrje.

Trajnimi është praktik dhe ndërveprues, me ushtrime konkrete dhe shembuj të aplikueshëm në punën e përditshme të pjesëmarrësve.

Ky workshop është pjesë e projektit të BERZH-it “Program mbështetës i Përmirësimit të Klimës së Investimeve në Shqipëri: Ndërtimi i Kapaciteteve të Shoqatave të Biznesit”, i zbatuar nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) dhe i financuar nga Sekretariati Shtetëror Zvicerian për Çështjet Ekonomike (SECO).

Objektivat

Ky workshop ka për qëllim të realizojë këto objektivat::

- Forcimin e kapaciteteve për avokim të besueshëm dhe strategjik.
- Pajisjen me mjete praktike për argumente dhe propozime të qarta.
- Zhvillimin e aftësive për komunikim publik dhe me vendimmarrësit.
- Rritjen e ndikimit institucional dhe dukshmërisë së organizatës.

Audienca e Synuar

- Drejtues Ekzekutivë, Sekretarë të Përgjithshëm dhe Oficerë të Lartë të Dhomave të Tregtisë dhe Shoqatave të Biznesit.
- Këshilltarë për komunikim, PR dhe ligjorë të angazhuar në avokim ose marrëdhënie me palët e interesuara.
- Staf i tjerë përgjegjës për përfaqësimin e interesave të anëtarëve dhe koordinimin me vendimmarrësit.

Pse Duhet të Merrni Pjesë?

- Do të mësoni si të ktheni shqetësimet e anëtarëve në propozime konkrete politikash.
- Do të fitoni mjete praktike për të komunikuar më qartë dhe më me ndikim me publikun, median dhe institucionet.
- Do të kuptoni si të rrisni besueshmërinë dhe peshën e organizatës suaj në proceset vendimmarrëse.
- Do të punoni mbi raste reale dhe ushtrime praktike të aplikueshme menjëherë në punën tuaj.

Certifikatë Pjesëmarrjeje

Pjesëmarrësit që përfundojnë workshop-in do të marrin një Certifikatë Pjesëmarrjeje.

Ky workshop do të zhvillohet në gjuhën shqipe.

13 shkurt 2026 | Teknikat bazë të avokimit të politikave

Fokusi i ditës:

Të pajisë pjesëmarrësit me mendësinë, strukturën dhe mjetet bazë për avokim të besueshëm, etik dhe efektiv, të mbështetur në interesin publik, përpara se të komunikohet.

Sesioni paradite | 10:30-13:00

Sesioni 1 – Çfarë është Avokimi i Politikave: Rregulla, Aktorë dhe Vendimarrje

- Parimet bazë për një avokim të besueshëm
- Mjetet e organizatave në procesin e politikëbërjes
- Rregullat e arta të avokimit
- Elementet e një fushate të suksesshme avokimi
- Shembuj praktikë dhe reflektim

Sesioni 2 – Nga problematika te çështja e avokimit: si të përcaktosh objektivin e avokimit

Mos avoko për gjithçka, por zgjidh betejën e duhur!

- Identifikimi i problematikave reale nga terreni dhe prioritare për anëtarët
- Kornizimi i çështjes: kush ndikohet, pse tani, sa i madh është ndikimi?
- Krahësimi me realitetin dhe vlerësimi i momentit të duhur
- Lidhja e problemit me interesin publik
- Ushtrim: Deklarata e problematikës në një fjali

DREKA | 13:00-14:15

Sesioni pasdite | 14:20-17:00

Sesioni 3 – Nga pyetja te evidenca: plani i kërkimit për avokim

Pa prova nuk ka avokim!

- Ndërtimi i bazës së evidencës: të dhëna zyrtare, anketa, intervista, media
- Logjika ekonomike dhe sociale e argumentit
- Si ndërtohet një argument i bazuar në evidencë
- Ushtrim: Skicimi i një plani kërkimi për një propozim politikash

Pushim kafeje

Sesioni 4 – Nga shkresa te ndikimi: si ndërtohet një propozim politikash efektiv

Shkresat që hapin dyert!

- Strukturimi i një propozimi politikash (problem – evidencë – zgjidhje – përfitim publik)
- Linja e duhur për të formuluar një kërkesë të qartë dhe të matshme
- Interesi publik – zemra e propozimit
- Gabimet që nuk duhen bërë
- Vetëvlerësimi për një propozim efektiv dhe bindës
- Ushtrim në grupe: Ndërtimi i një propozimi politikash të shkurtër dhe prezantimi

Folëse: Jonida Skëndaj

14 shkurt 2026 | Strategjitë e komunikimit në avokim

Fokusi i ditës:

Si shndërrohet propozimi i ndërtuar në Ditën 1 në mesazh publik, dukshmëri mediatike dhe veprime komunikimi që ndikojnë vendimmarrjen.

Sesioni paradite | 09:00-12:00

Sesioni 1 – Nga argumenti në mesazh publik

Çfarë themi, si e themi dhe pse duhet të na dëgjojnë!

- Përkthimi i propozimit të politikave në mesazh të qartë komunikimi
- Interesi publik si boshti i narrativës
- Thjeshtimi pa humbur substancën
- Një mesazh bazë → disa versione sipas audiencës
- Çfarë nuk duhet komunikuar publikisht

Pushim kafeje

Sesioni 2 – “Brand-imi”, Kornizimi dhe Audiencat

Nëse nuk mbahet mend, nuk funksionon!

- Kornizimi strategjik i çështjes si pjesë e strategjisë së komunikimit
- Emërtimi i kauzës, slogani dhe narrativa publike
- Audiencat kryesore: publiku, media, vendimmarrësit, partnerët
- Gjuha që bashkon dhe shmang polarizimin
- Gabime tipike në kornizim që dëmtojnë besueshmërinë
- Ushtrim praktik: Nese nuk mbahet mend, nuk funksionon!

DREKA | 12:00-13:15

Sesioni pasdite | 13:20-16:00

Sesioni 3 – Media si Aleat Strategjik (Perspektiva e medias – nga brenda redaksisë)

Si mendon media dhe çfarë e bën një histori të vlefshme për t’u mediatizuar

- Si funksionon realisht media: ritmi, presioni, kriteret e lajmit
- Çfarë kërkojnë gazetarët dhe çfarë i largon
- Si ndërtohet një histori që merret dhe publikohet
- Struktura e një njoftimi për shtyp që lexohet
- Intervista, konferenca shtypi dhe citimet
- Media tradicionale vs. rrjetet sociale: rreziqe dhe mundësi
- Menaxhimi i keqkuptimeve dhe situatave të ndjeshme
- Ushtrim praktik

Pushim kafeje

Sesioni 4 – Nga vëmendja te vendimi

Kur komunikimi kthehet në ndikim

- Lidhja e komunikimit publik me vendimmarrjen institucionale
- Takime me vendimmarrës: si përgatitet dhe strukturohet mesazhi
- Roli i materialeve të avokimit
- Monitorimi i reagimit publik, mediatik dhe institucional
- Ruajtja e reputacionit dhe qëndrueshmëria e mesazhit
- Ushtrim praktik

Jonida Skëndaj



 [Jonida Skendaj](#)

Jonida Skëndaj është avokate e licencuar në Shqipëri, me 20 vjet përvojë në të drejtën e biznesit, kornizat rregullatore dhe çështjet e politikave të lidhura me BE-në.

Puna e saj ligjore përfshin këshillimin e kompanive dhe shoqatave të biznesit mbi navigimin në mjedise komplekse rregullatore, me fokus të veçantë te pajtueshmëria, licencat dhe lejet, qeverisja korporative, konkurrenca, kontratat dhe transpozimi i ligjeve të BE-së.

Përveç praktikës ligjore, ajo është bashkë-themeluese e një grupi rajonal për tregtinë e energjisë, gjë që i jep një njohuri të drejtpërdrejtë mbi ndikimin praktik të rregulloreve në biznes, si në nivel lokal, rajonal, ashtu edhe në perspektivë të BE-së.

Ajo është gjithashtu anëtare e Këshillit Kombëtar për Menaxhimin e Trashëgimisë Kulturore, një organ këshillimor pranë Ministrisë të Kulturës, dhe ky rol ka forcuar kuptimin e saj praktik mbi vendimmarrjen publike, koordinimin institucional dhe proceset e konsultimit.

Jonida ka shërbyer si delegate dhe anëtare pranë komisioneve të shoqatave të biznesit dhe aktualisht është anëtare e Bordit të Fondacionit “Lorik Cana 5”, e angazhuar në promovimin e sportit për të rinjtë dhe trashëgimisë kulturore shqiptare, dhe ka kontribuar në disa publikime ligjore ndërkombëtare.

Si eksperte ligjore kombëtare për këtë workshop, ajo sjell një qasje praktike dhe të bazuar në evidencë për avokimin e politikave, proceset e konsultimit dhe angazhimin efektiv me institucionet shqiptare.

Jerina Lalaj



 [Jerina Lalaj](#)

Jerina Lalaj është stratege komunikimi dhe konsulente PR me mbi dy dekada përvojë në media, brandim dhe komunikim strategjik.

Si ish-Drejtuuese e Marketingut dhe Komunikimit për kanalet kryesore televizive, ajo sjell një njohuri të thellë mbi mënyrën se si mendojnë gazetarët dhe si fiton dukshmëri një histori.

Si themeluese dhe Drejtuese Ekzekutive e JL Consulting Albania, ajo udhëheq fushata që forcojnë marka, menaxhojnë reputacionin dhe ndërtojnë besimin publik.

Me përvojë që përfshin Shqipërinë, Spanjën dhe Italinë, Jerina njihet për aftësinë e saj për të krijuar mesazhe bindëse, për të menaxhuar marrëdhëniet me median dhe për të udhëhequr organizatat në zhvillimin e strategjive komunikimi me ndikim.

Ajo gjithashtu drejton Fondacionin “Lorik Cana 5”, duke promovuar sportin, kulturën dhe fuqizimin e të rinjve përmes iniciativave të bazuara në komunitet.